



REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <b>2-D/DPK</b>	Nr Prot. Br Prot. <b>01-3365/13</b>
Nr. i faq. Broj stranica Nr. pages <b>02</b>	Data Datum Date <b>14.10.2013</b>
PRISHTINE	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1.1), nenin 5 (paragrafi 1.5) dhe nenin 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 (paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 08.10.2013, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-2515/13, për z. Nexhbedin Doli – Anëtar i Bordit në Ndërmarrjen Publike “Ngrohtorja e Qytetit” në Gjakovë, për shkak se zyrtari i lartë ka shmangur situatën e konfliktit të interesit.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

**I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik, nr. AKK – 03-2515/13, për zyrtarin e lartë z. Nexhbedin Doli – Anëtar i Bordit në Ndërmarrjen Publike “Ngrohtorja e Qytetit” në Gjakovë, dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznesin individual N.P.SH. “AEP”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.**

Në këtë rast, zyrtari i lartë z. Doli është hetuar për situatë të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe me datë 09.09.2013 është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit.

Pas pranimit të kësaj shkrese, zyrtari në fjalë, është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë dhe ka deklaruar se do të heqë dorë nga të qenit person i autorizuar në biznesin në fjalë.

Pas kësaj, z. Doli ka dërguar informacionin zyrtar të lëshuar nga Agjensioni i Regjistrimit të Bizneseve (DPKI 03-3135/13) në të cilën vërtetohet se i njëjti ka hequr dorë nga të qenit person i autorizuar në biznesin e lartpërmendur.

Prandaj, duke pasur parasysh këto të dhëna, konstatojmë se gjendja e konfliktit të interesit është shmangur pasi që z. Nexhbedin Doli ka bërë ndryshimet e kërkuara nga Agjencia.

Andaj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

